

dialoguqeveridonatorë

Buletin Informativ – Janar 2011, Botimi nr. 46

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al



■ Foto: Presidenti i Rajonit të Lombardisë, Roberto Formigoni, Kryeministri Sali Berisha, Kryetari i qytetit të Milanos, Letizia Moratti, Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Saba D'Elia gjatë hapjes së Forumi Ekonomik Italo-Shqiptar në Milano.

Forumi Ekonomik Italo-Shqiptar në Milano

Në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, në 18 Janar 2011, u organizua në Milano të Italisë Forumi Ekonomik Italo-Shqiptar për të diskutuar mbi marrëdhëniet tregtare ndërmjet dy shteteve dhe për të nxitur akoma më shumë bashkëpunimin ekonomik. Forumi u organizua pranë selisë së Dhomës së Tregtisë së Milanos me iniciativë të Komunës së Milanos në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadën Italiane në Tiranë. Në aktivitetet morrën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe ekonomike të të dyja vendeve. Delegacioni shqiptar u kryesuar nga Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Z. Sali Berisha, Zv/Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Z. Eno Bozdo, Kryetari i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Z. Ilir Zhilla dhe përfaqësues të tjerë nga institucione qendrore dhe përfaqësues të botës së biznesit. Pjesëmarrës për palën italiane ishin Ministri i zhvillimit ekonomik, Paolo Romani, President i Rajonit të Lombardisë, Roberto Formigoni, Kryetarja e Bashkisë së Milanos, Letizia

Moratti, si dhe përfaqësues për Ministrinë e Punëve të Jashtme italiane, Amasadori i Italisë në Shqipëri, Saba D'Elia dhe Drejtori i Kooperacionit Italian për Zhvillim në Shqipëri, Aldo Sicignano.

Kryetarja Moratti theksoi se ekonomia, sipërmarrja, solidariteti dhe miqësia lidhin Milanon dhe popullin Shqiptar dhe se Shqipëria dhe Italia do të vijojnë të bashkëpunojnë në kuadër të projekteve të ndryshme të zhvillimit dhe progresit për rritjen e të dyja vendeve. Kryeministri Berisha bëri një tablo të gjerë të burimeve, potencialeve dhe mundësive që ofron Shqipëria për investitorët italianë. Ai theksoi gjithashtu se biznesi Italian është një nga promotorët e zhvillimit të biznesit në Europë dhe botë dhe fakti që ai tregon interes për Shqipërinë është një ogur i mbarë për vendin dhe ekonominë shqiptare. Sipas Drejtorit të Kooperacionit Italian për Zhvillim në Shqipëri, Aldo Siciliano, Italia është aktualisht partneri kryesor tregtar për Shqipërinë dhe donatori kryesor për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri. Ky përcaktim ka ardhur si pasojë e rezultateve të arritura gjatë viteve dhe veçanërisht nëpërmjet Pro-

gramit për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME) në Shqipëri, i cili kontribuon në rritjen ekonomike dhe sociale të Shqipërisë, duke favorizuar zhvillimin e sektorit privat dhe duke lehtësuar qasjen e SME-ve ndaj financimeve me kushte lehtësuese. Gjatë aktivitetit dy vjeçar, Programmi që koniston në një linjë kredie dhe një fond garance në favor të bizneseve shqiptare prej 45 milion Euro, ka financuar projektet e 39 SME-ve për blerjen e teknologjisë italiane duke ndikuar kështu në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë shqiptare. Gjatë eventit u prezentua një brochure e realizuar nga Kooperacioni Italian për Zhvillim që ilustron në detaje Programin e Zhvillimit të Sektorit Privat. Në përfundim të takimit ku morrën pjesë më shumë se 400 sipërmarrës dhe biznesmenë italianë dhe shqiptarë u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Dhomës së Tregtisë së Milanos dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, i cili është shumë i rëndësishëm pasi garanton bashkëpunimin në të ardhmen ndërmjet bizneseve shqiptare dhe atyre italiane.

Në këtë numër:

- **Forumi Ekonomik Italo-Shqiptar në Milano**
- **Drejtorja e lartë e Bankës Botërore viziton Shqipërinë**
- **Ambasadori i ri i BE-së, Ettore Sequi, i paraqet letrat kredenciale**
- **Bashkëpunimi i decentralizuar, në krye të axhendës së Konferencës Ndërkombëtare**
- **Takime të Grupi Mbështetës të SPI-së dhe GSP-së për prokurimin**
- **BE prezanton projektin Regjistrimi i popullsisë dhe banesave 2011**
- **Zvicra Mbështet Përfundimin e Suksesshëm të Studimit të Fizibilitetit të Sigurisë së Digave në Shqipëri**
- **Rajonet shqiptare gjejnë partnerë projektsh në Kroaci dhe Slloveni**
- **Finlanda mbështet Shqipërinë nëpërmjet Programit Një OKB**
- **PAMECA organizon kurse trainimi për çështjet detare**
- **Kurs trajnimi mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në shëndet**



■ Për të qëndruar në ballë në një botë gjithnjë e më të integruar, tha Drejtorja e Lartë e Bankës, Ngozi Okonjo-Iweala, Shqipërisë do t'i duhet një strategji më e sofistikuar që të ndërtojë themelin për aftësi konkurruese dhe qëndrueshmëri afatgjatë

Drejtorja e lartë e Bankës Botërore viziton Shqipërinë

Drejtorja e lartë e Bankës Botërore, Ngozi Okonjo-Iweala kreu një vizitë tre-ditore në Shqipëri nga data 9 deri 11 janar 2011, në kuadër të udhëtimit të saj në disa vende të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i vizitës së saj të parë ishte të theksonte rëndësinë e Programit të Ri të Zhvillimit të Shqipërisë si edhe të ripërsëriste mbështetjen e Bankës për Qeverinë mbeshteur ne Strategjinë e Partneritetit per Vendin. Përveç kësaj, Znj Ngozi Okonjo-Iweala shprehu solidaritetin e Bankës me njerëzit e prekur nga përmbytjet e mëdha të kohëve të fundit në zonën e Shkodrës dhe diskutoi mundësitë për mbështetje të mëtejshme në të ardhmen për zbutjen e rreziqeve të përmbytjeve të tjera që mund të ndodhin. Znj Okonjo-Iweala u takua me Kryeministrin Sali Berisha, anëtarë të kabinetit, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, udhëheqësin e opozitës, z. Edi Rama, dhe me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të sektorit privat. Diskutimet gjatë këtyre takimeve u përqendruan në zbatimin e Strategjisë së Re të Partneritetit me Vendin (SRPV) dhe te sfidat me të cilat përballlet Shqipëria për të rifituar shkallën e saj të lartë të zhvillimit në botën e pas-krizës.

“Për të qëndruar në ballë në një botë gjithnjë e më të integruar, tha Drejtorja e Lartë e Bankës, Ngozi Okonjo-Iweala, Shqipërisë do t'i duhet një strategji më e sofistikuar që të ndërtojë themelin për aftësi konkurruese dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Disa nga elementët kyç të kësaj strategjie do të ishin reforma të mëtejshme ne arsim, teknologji të informacion-

it dhe komunikimit, dhe sektori energjetik.

Gjithashtu është me rëndësi të përmirësohet mjedisi që mundëson zhvillimin e biznesit, duke përfshirë të drejta të sigurt pronësie dhe zbatimin e efektshëm dhe transparent të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese”.

Në ditën e fundit të vizitës së saj, Znj Okonjo-Iweala vizitoi zonën e Porto Romanos, në afërsi të Durrësit, ku rreziqet mjedisore dhe shëndetësore të një ish uzine kimike janë duke u eliminuar me ndihmën e Bankës Botërore dhe Qeverisë Holandeze në kuadër të Projektit të Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare. Deri më sot, 65% e punës riparuese është kryer dhe pastrimi i të gjithë zones pritet të përfundojnë deri më maj 2011. Në Komunën Udenisht të rrethit të Pogradecit, ajo vizitoi një parcelë të pëlëzuar dhe një plantacion me pemë frutore dhe u takua me përfituesit e Projektit për Zhvillimin e Burimeve Natyrore, të financuar nga Banka Botërore, Global Environmental Facility, dhe Qeveria Suedeze. Investimet në këtë komunë përfaqësojnë 63 për qind të pyjeve dhe kullotave dhe 37 për qind të tokave bujqësore të përmirësuar. Si pasojë, ne kete komunë janë të punësuar 204 persona qe merren me përmirësimin e pyjeve, dhe deri tani, kanë përfituar 200 familje. “Banka Botërore është shumë krenare që punon së bashku me Qeverinë dhe komunitetet vendore për zbatimin e këtyre projekteve të rëndësishme, të cilët në një vend pastrojnë dhe përmirësojnë kushtet e jetës së njerëzve, ndërsa në një vend tjetër, krijojnë vende pune në nivel lokal”, deklaroi znj. Okonjo-Iweala.

Strategjia e re e Bankës Botërore e Partneritetit me Bankën Botërore, e miratuar

më korrik 2010, përfshin financimin nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) deri më 275 milione dollarë amerikanë dhe nga IFC-ja, deri më 120-150 milione dollarë amerikanë në një periudhë katër vjeçare. Aktualisht, në Shqipëri, ka 15 projekte në zbatim në sektorin social, shëndetësi, arsim, burime natyrore, ujë dhe energjetikë, infrastrukturë vendore, dhe menaxhimin të sektorit publik, të cilët po e ndihmojnë Shqipërinë të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social dhe në rrugën drejt integritit evropian të saj.

Ambasadori i ri i BE-së, Ettore Sequi, paraqet letrat kredenciale

Me paraqitjen e letrave kredenciale Presidentit të Republikës, z. Bamir Topi, më 20 janar 2011, z. Ettore Sequi u bë formalisht Ambasadori i ri i Bashkimit Evropian dhe Shefi i Delegacionit të BE-së në Shqipëri. Në ceremoninë e prezantimit të letrave kredenciale të tij, Ambasadori Sequi tha: "Ndjehem veçanërisht i privilegjuar që jam emëruar në këtë post të rëndësishëm në një kohë sfidash për Shqipërinë. Liberalizimi i vizave ishte një sukses i vërtetë për shqiptarët, por është e nevojshme të ruhet ritmi në përpjekjet e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe veçanërisht të mobilizohen të gjitha energjitë e vendit për të plotësuar në kohën e duhur prioritetet kyçe të përcaktuara në Opinionin e Komisionit Evropian." Zoti Sequi u emërua Shef i ri i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri në fillim të shtatorit 2010 nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtë dhe Çështjet e Sigurisë, Zëvendës-presidentja e Komisionit Evropian, Baronessa Catherine Ashton, në kuadër të emërimeve të para për Shërbimin e ri të Jashtë të Bashkimit Evropian (EEAS). Ambasadori Sequi e nisi karrierën e tij në Shërbimin e Jashtë Italian më 1985. Që nga viti 1988 ai shërbeu si konsull i Italisë në Teheran dhe më pas si Këshilltar në Përfaqësinë e Përhershme të Italisë në Kombet e Bashkuara në Nju Jork dhe Këshilltar në Kabinetin e Ministrave të Jashtë të Italisë. Nga korriku i vitit 2000 deri në dhjetor të 2004 ai shërbeu si Zëvendës Ambasador i Italisë në Tiranë. Zoti Sequi vjen në Shqipëri pas një misioni me shumë sfida në Afganistan, së pari si Ambasador i Italisë në Kabul dhe më pas si i Përfaqësues i Posaçëm i Bashkimit Evropian në Afganistan dhe Pakistan.



Foto: Ambasadori i ri i BE-së, Ettore Sequi, gjatë një konference shtypi

Bashkëpunimi i decentralizuar, kryeson axhendën e Konferencës Ndërkombëtare

Përfaqësues të Qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane, Organizatave Ndërkombëtare, Autoriteteve vendore të Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit, përfaqësues të sektorit privat, shoqërisë civile dhe medias moren pjesë në konferencën dy ditore "Integrimi Evropian, njohuri, risi dhe qeverisja demokratike për zhvillim" – Roli strategjik i bashkëpunimit të decentralizuar në sektorët e ekonomisë, mjedisit, shërbimeve dhe trajnimeve, të organizuar në Tiranë, më 13-14 janar 2011. Aktiviteti u organizua nga Ministria e Brendshme, Programi i PNUD-it ART GOLD 2, Ambasada Italiane në Tiranë dhe Agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Ajo u organizua si pjesë e programit ART GOLD 2, që zbatohet nga PNUD me mbështetjen financiare të Qeverisë Italiane, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara. Projekti ka si qel-

lim mbështetjen e politikave kombëtare për zhvillim vendor si pjesë e procesit të Integritit Evropian me një fokus të veçantë në qeverisjen demokratike. Gjatë hapjes së kësaj konference, Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Z. Saba D'Elia theksoi rolin e protagonistit të kësaj konference: të komunitetit vendor shqiptar dhe atij evropian të udhëhequr nga administratat e tyre publike të cilat po përdorin programin ART GOLD për të zhvilluar një bashkëpunim të decentralizuar premtues. "Premtues mbi të gjitha sepse përbëhet nga projekte inovative që po rezultojnë efikase, por mbi të gjitha falë vullnetit që kanë qarqet, bashkitë dhe komunat për të kontribuar sëbashku në zbatimin e strategjive të përqëndruara për zhvillim", u shpreh gjatë fjalës së tij Ambasadori Italian. Koordinatorja e Përhershme e OKB-së në Shqipëri dhe Përfaqësuesja e Përhershme e PNUD-it, Znj. Zineb Toumi-Benjelloun, gjatë konferencës u shpreh: "Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka hedhur një hap të rëndësishëm në fushën e zhvillimit rajonal. Tashmë ekziston një politikë kombëtare për zhvillimin rajonal



Foto: Konferenca dy ditore "Integrimi Evropian, njohuri, risi dhe qeverisja demokratike për zhvillim" – Roli strategjik i bashkëpunimit të decentralizuar në sektorët e ekonomisë, mjedisit, shërbimeve dhe trajnimeve, të organizuar në Tiranë, më 13-14 janar 2011.

dhe po vazhdojnë përpjekjet për forcimin e reformës decentralizuese dhe po bëhen ndryshimet e nevojshme institucionale për t'iu përgjigjur mundësive të paraqitura nga statusi i vendit kandidat në BE". Ngjarja u përqëndrua në cilësinë dhe qeverisjen e zhvillimit territorial, rolin e agjencive të zhvillimit rajonal, si mekanizma të zhvillimit territorial, ekonomik dhe social. Në konferencë u theksuan rëndësia e trainimit të profesionistëve të zhvillimit përmes laboratorëve territoriale të zhvillimit njerëzor lokal si pjesë e iniciativës së hapjes së Shkollës Ndërkombëtare të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Programi ART-GOLD2 i PNUD-it shihet si një nga mjetet më të efektshme në dispozicion të qeverisë për promovimin e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit njerëzor në rajonet e synuara. Krijimi i Laboratoreve të Zhvillimit Njerëzor në rajonet e Shkodrës dhe Vlorës, si pjesë e Shkollës Ndërkombëtare gjithashtu u pa si një mekanizëm integral në avancimin e bashkëpunimit të decentralizuar. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan mbi rolin që autoritetet lokale dhe aktorët lokalë social duhet të luajë në procesin e integritimit në BE dhe shprehu vlerësimin për përpjekjet e PNUD-it, agjencive të OKB-së dhe donatorëve për të përgatitur një kuadër operacional, në përputhje me orientimet e prioritetëve kombëtare, ku të gjithë aktorët ndërkombëtarë dhe të bashkëpunimit të decentralizuar mund të jetë në gjendje për të harmonizuar veprimet e tyre. Kjo konference u drejtua dhe moderua nga qeveria, me pjesëmarrjen e Zëvendës Ministrit të Brendshëm, Z. Ferdinand Poni. Panele të ndryshme u kryesuan nga Ministria e Integritimit, Znj. Majlinda Bregu, Ministri i Mjedisit, Z. Fatmir Mediu dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i përfaqësuesve ishte nga institucionet shqiptare dhe atyre të Ballkanit, universitetet, agjencitë lokale të zhvillimit ekonomik të Vlorës dhe të Shkodrës, shkëmben eksperiencat e fituara gjatë viteve të fundit në Shqipëri.

Grupi Mbështetës i SPI-së mban mbledhjen e tij të parë për vitin 2011

Mbledhja e Grupit Mbështetës të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) u mbajt më 25 janar 2011 në Këshillin e Ministrave. Në të morën pjesë përfaqësues të Ministrive të Financës dhe Integritimit Evropian, DEBASKON-it, Departamentit



Foto: Mbledhja e Grupit Mbështetës të SPI-së, u mbajt më 25 janar 2011

të Administratës Publike dhe donatorët të cilët kontribuojnë në Fondin e Besimit të SPI-së. Mbledhja u bashkë-drejtuara nga Zëvendës Ministri i Financave, Nezir Haldeda dhe nga Drejtorja e DEBASKON-it, Valbona Kuko. Axhenda e takimit përfshinte diskutime rreth progresit të SPI-së dhe aktiviteteve të ndërmarra në përgjithësi, duke u përqëndruar në progresin në zbatimin e Fondit të Besimit të SPI-së dhe hapat e mëtejshme. Zbatimi i Fondit të Besimit të SPI-së është shtyrë deri në shtator 2011, me një buxhet total të financuar nga donatorët në shumën 5.5 milionë euro, që ka bërë të mundur vazhdimin e zhvillimit dhe testimit të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Financave Shqiptare (AFMIS), si edhe vlerësimin dhe rishikimin afat-mesëm të SKZhIsë dhe trajnimin e zyrtarëve qeveritarë. Në mbledhje Qeveria u kërkoi donatorëve një vazhdimësi të Fondit të Besimit të SPI-së edhe pas vitit 2011. Donatorët shprehën kënaqësinë e tyre për progresin e bërë që prej mbledhjes së fundit të Grupit Mbështetës, të mbajtur në maj 2010, dhe për një marrëdhënie dhe bashkëpunim më të mirë me institucionet qeveritare. Ata u shprehën të gatshëm për të vazhduar mbështetjen e tyre në zbatimin e SPI-së.

Takim i grupit sektorial të punës për prokurimin publik

Më 27 janar 2011 zhvilloi takim grupi sektorial i punës për prokurimin publik. Në takim morën pjesë përfaqësues të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), DEBASKON-it, Ministrive të Financave dhe Integritimit Evropian, dhe donatorë të cilët kontribuojnë në zhvillimin e prokurimit publik. I kryesuar nga Dre-

jtoria e Agjencisë së Prokurimit Publik, Klodiana Cankja, takimi shërbeu si mundësi për të diskutuar rekomandimet kryesore dhe matricën e fushave për përmirësime, që rezultuan nga Raporti i Vlerësimit të Prokurimit që u finalizua në korrik 2010, dhe për të diskutuar hapat e mëtejshëm. Rekomandimet për forcimin e sistemit të prokurimit publik përqëndrohen në elemente si zhvillimi i kapaciteteve, zhvillimi i Kuadrit të Kontrollit të Brendshëm dhe modernizimi i kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm. Drejtorja e Departamentit Juridik, të Monitorimit dhe Publikimit në APP, Reida Kashta, bëri një analizë të rekomandimeve të vlerësimit dhe një përshkrim të mbështetjes që po sigurohet nga donatorë të ndryshëm për vënien në jetë të këtyre rekomandimeve. Nëpërmjet projektit të Marrëveshjes Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit, USAID ka mbështetur reformat qeveritare në fushën e prokurimit publik. Banka Botërore po financon kontrollin me sistem të plotë të platformës së prokurimit qeveritar elektronik, për të vlerësuar përditësimet e fundit për të zbatuar rekomandimet që rezultuan nga një kontroll i mëparshëm i kryer me mbështetjen e USAID-it në vitin 2008. Nëpërmjet Programit të Binjakëzimit, BE ka mbështetur fuqizimin dhe modernizimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm dhe kohët e fundit ka nisur një fazë të re për mbështetjen e përmirësimit të sistemit të prokurimit publik përmes projektit të binjakëzimit të IPA 2008: *Mbështetja për fuqizimin e sistemeve të prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandeve publike në Shqipëri me standardet e BE-së*. Nga ana tjetër, BERZH po financon Projektin për Mbështetjen për Reformën e Prokurimit Publik të Utiliteteve.

BE prezanton projektin Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011

Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011 do të jetë sfidë e madhe dhe e rëndësishme për Shqipërinë. Rruga e Shqipërisë drejt BE-së është një prej arsyeve që Delegacioni i Bashkimit Evropian i kushton vëmendjen më të madhe statistikave të cilësisë më të lartë. BE u kushton vëmendje të vazhdueshme të gjitha çështjeve dhe po e ndihmon fuqimisht Shqipërinë për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave statistikore, për të siguruar krahasueshmërinë dhe për të siguruar përdorimin e këtyre të dhënave me përgjegjësi. Mbështetja për INSTAT-in për realizimin e RREGJISTRIMIN e Popullsisë dhe të Banesave sipas standardeve dhe rekomandimeve të BE-së dhe atyre ndërkombëtare, dhe për të rritur kapacitetin në përpunimin, analizën dhe shpërndarjen e të dhënave të Regjistrimit janë objektivat kryesorë të projektit prej 8 milionë eurosh të financuar nga BE nën IPA Kombëtar 2009. Për të shënuar nisjen e projektit, *Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011*, u zhvillua një ceremoni prezantimi në Zyrat e Delegacionit të Bashkimit Evropian më 13 janar 2011. Në ceremoni morën pjesë Drejtorja e Përgjithshme e INSTAT-it, Ines Nurja, dhe zyrtarë të tjerë përgjegjës të INSTAT-it, zyrtarë të Delegacioni i Bashkimit Evropian, përfshirë Shefin e Operacioneve II, Francois Begeot, dhe Menaxheren e Programit, Xheni Sinakoli, si dhe ekipi i projektit. Gjatë ceremonisë së prezantimit, Francois Begeot, theksoi mbështetjen e rëndësishme financiare që i është dhënë INSTAT-it gjatë viteve të fundit. Ai përmendi shifrën 2.85 milionë euro nën programin IPA 2007, që mbuloi Llogaritë Kombëtare, regjistrimin ekonomik dhe të bizneseve, si dhe rreth 8 milionë euro nën programin IPA 2009 për të mbështetur Regjistrimin e Popullsisë dhe të Banesave. Ai këmbënguli në nevojën që INSTAT të përgatitet mirë para se të fillojnë operacionet e regjistrimit në terren. "Përgatitja e mirë është kyç për suksesin e regjistrimit" tha ai. Drejtorja e përgjithshme e INSTAT-it, Ines Nurja, tha se fushat kryesore për të cilat nevojitet mbështetje nga ky projekt janë: logjistika e regjistrimit, pyetësorët dhe përpunimi i të dhënave të regjistrimit. Ekipi i INSTAT-it për Regjistrimin bëri një përshkrim të përgjithshëm të veprimtarive përgatitore



■ Foto: Shefi i Operacioneve të Delegacioni i Bashkimit Evropian, Francois Begeot, Menaxherja e Programit, Xheni Sinakoli, dhe Drejtorja e INSTAT-it, Ines Nurja, gjatë ceremonisë së prezantimit të projektit Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011

të ndërmarra nga INSTAT që nga viti 2008 dhe theksoi punën që kërkohet në fushën e menaxhimit, metodologjisë dhe logjistikës së regjistrimit, afatin kohor dhe buxhetin për operacionin e regjistrimit, përgatitjen e materialeve të trajnimit dhe përcaktimin e strategjisë për shpërndarjen e të dhënave të regjistrimit. Ekipi i projektit paraqiti komponentët kryesorë të projektit, planin e veprimit dhe metodën e propozuar për zbatimin e projektit. U theksua gjithashtu nevoja që INSTAT të bashkërendojë me të gjithë donatorët për të përsosur teknikalitetet dhe burimet. Projektet e financuara nga BE, të cilat po zbatohen për të ndihmuar statistikën dhe regjistrimin, kapin shifrën e 10.85 milionë eurove (8 milionë euro nëpërmjet projektit IPA 2009 dhe 2.85 milionë euro nëpërmjet projektit IPA Kombëtar 2007). Kjo ndihmë po kontribuon në statistika më të sakta, të besueshme dhe të krahasueshme në fushën e popullsisë, strehimit, biznesit dhe bujqësisë. IPA 2009 përfshin një kontratë shërbimi, një kontratë furnizimi dhe një grant të drejtpërdrejtë për INSTAT-in. Kontrata e shërbimit do të zbatohet nga Instituti ICON në bashkëpunim me CIRPS – Universiteti Sapienza i Romës – dhe do të mbështesë INSTAT-in në: përgatitjen e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave sipas standardeve dhe rekomandimeve evropiane dhe ndërkombëtare; kryerjen e numërimit të përgjithshëm; rritjen e kapacitetit të INSTAT-it në përpunimin, analizën dhe shpërndarjen e të dhënave të Regjistrimit. Granti i drejtpërdrejtë do të administrohet nga INSTAT dhe objektivat konkrete të tij janë: të mbështesë përgatitjen, organizimin dhe menaxhimin e operacioneve në terren për Regjistrimin e Popullsisë dhe të Banesave 2011 në Shqipëri, përfshirë shpërbimin e stafit që do të punojë në terren, pagesën për operatorët dhe mbikëqyrësit e regjistrimit të të dhënave,

dhënieve të dietave për numëruesit të cilët do të marrin pjesë në veprimtaritë e trajnimit; të mbështesë ngritjen dhe funksionimin e zyrave të regjistrimit në rajone dhe qarqe; si dhe të mbështesë shtypshkrimin e materialeve të regjistrimit dhe t'ua dërgojë ato zyrave rajonale të INSTAT-it dhe zyrave vendore të regjistrimit. Shqipëria përfiton edhe nga programi rajonal IPA për shumë përfitues, IPA 2007-2009, me 12.4 milionë euro, që përfshin të gjitha vendet kandidatë dhe potencialisht kandidatë për të hyrë në BE.

Zvicra Mbështet Përfundimin e Suksesshëm të Studimit të Fizibilitetit të Sigurisë së Digave në Shqipëri

Zvicra duke qenë donatori i parë që mbështet fuqimisht Shqipërinë në zhvillimin e një sektori të qëndrueshëm dhe funksional të energjisë elektrike që nga viti 1992, është vlerësuar shumë lart nga autoritetet, donatorët dhe popullsia. Një shembull i mirë është kryerja me sukses e studimit të Fizibilitetit të Sigurisë së Digave mbi kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat, financiar nga Zvicra me rreth 1 milion euro. Bazuar në studimin e fizibilitetit, programi i sigurisë së digave është dizajnuar në koordinim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (METE) dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) si një program i mbështetur prej shumë donatorëve, me një shumë totale prej 84 milion euro, që përbëhet nga paketa të pavarura investimi që do të financohen nga Banka Botërore (WB): 42 milion euro, Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW): 20 milion euro, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD): 10 milion euro, Zvicra: 4.3 milion euro si edhe kontributi i KESH-it me 7.6 milion euro. Zvicra synon të kontribuojë në mënyrë

të veçantë për të rritur sigurinë e digave Shqiptare sipas standarteve europiane në mënyrë që të mbrojnë njerëzit që jetojnë poshtë djefit të poshtëm të digave si dhe për të garantuar një prodhim të qëndrueshëm të hidro-energjisë, i cili është vendimtar për të gjithë furnizimin me energji në vend. Siguria e digave është një fushë në të cilën Zvicra ka një avantazh të krahasueshëm. Duke rritur sigurinë e digave në vend sipas standarteve Europiane, Shqipëria forcon integrimin e saj në Komunitetin të Energjisë së Europës Juglindore si një lojtare strategjike (furnizuese e ndërmjetme nëpërmjet akumulimit të energjisë).

Një Vlerësimi i Pavarur, i kryer në 2010, vlerësoi shumë impaktin e katër projekteve të përfunduara Zvicerane për energjinë. Ky kontribut Zviceran në sektorin e energjisë, me rreth 24 milion euro, ka sjellë këto rezultate të prekshme: Së pari, ekuaktiviteti i impaktit, nëpërmjet projektit të "transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë", është vlerësuar për kontributin në kursimet e rreth €700 milion në vit, ndërsa rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës ka kontribuar në realizimin e të ardhurave nga energjia elektrike për KESH-in me 87 milion euro në vit.

Së dyti, furnizimi më i mirë me energji është arritur, pasi u shmang e ndërprerja e energjisë në dimrin e viteve 2009-2010 në sajë të "projektit të importeve kritike". Një e treta e popullsisë Shqiptare nuk u përball me ndonjë ndërprerje të rëndësishme të energjisë në zonat e Durrësit dhe Tiranës, me përfundimin e suksesshëm të një nënstacioni të ri elektrik. Së treti, besueshmëria e prodhimit të energjisë është përmirësuar me rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës, duke patur parasysh se numri i orëve të ndërprerjeve të detyrueshme të energjisë ra ndjeshëm nga 8.6 orë në 2001 në 2.5 orë në 2008, ndërsa ekikasiteti i përdorimit të ujit është përmirësuar me 3-4% dhe jetëgjatësia e turbinave është rritur deri në 25 vjet.



Foto: Hidrocentrali i Fierzës dhe diga mbi kaskadën e lumit Drin

Rajonet shqiptare gjejnë partnerë projektësh në Kroaci dhe Slloveni

Zyrtarë të rajoneve të Lezhës dhe Shkodrës, të cilët kanë miratuar strategjitë e tyre të zhvillimit rajonal, zhvilluan një vizitë studimore në Slloveni për të mësuar për financimin dhe zbatimin e projekteve të BE-së për zhvillimin rajonal. Delegacioni i përbërë nga stafi drejtues i administratës së Qarkut, Kryetari i rajonit të Lezhës, Bardh Rica, dhe profesorë universitetesh dhe aktivistë të OJQ-ve në rajon, u mbështet nga Programi për Zhvillim Ekonomik dhe Punësim i GIZ-it. Delegacioni zhvilloi takime me Zyrën Qeveritare Sllovene për Vetë-qeverisjen Vendore dhe Politikat Rajonale, Agjencitë e Zhvillimit Rajonal të Rajonit Urban të Ljubljanes dhe të rajonit të planifikimit Notranjsko-Kraška, si dhe me Sekretariatën e Përbashkët Teknik të programit CBC Slloveni/Itali. Ata vizituan gjithashtu projekte të ndryshme të financuara nga BE, ndër të cilat edhe Muzeun e Armëve në Pivka, të financuar nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal. Si rezultat i këtij turneu vizitash, administrata rajonale do

t'i bashkohet qytetit të Rijekës në shkëmbimin e propozimeve për projekte lidhur me trashëgiminë industriale dhe mobilitetin social, dhe do të kërkojë institucione partnere sllovene për një projekt IPA Adriatik për trashëgiminë kulturore në rajonin e Shkodër-Lezhës. GIZ u formua më 1 janar 2011 dhe bashkon ekspertizën e Deutscher Entwicklungsdienst (DED) GmbH (Shërbimi Gjerman për Zhvillim), Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ) GmbH (Bashkëpunimi Teknik Gjerman) dhe Inwent – Ndërtimi i Kapaciteteve Ndërkombëtar, Gjermani.

Finlanda mbështet Shqipërinë nëpërmjet Nismës Një OKB

Më 11 janar 2011, Finlanda u bë donatori më i fundit që mbështet Programin Një OKB në Shqipëri me një kontribut prej 300,000 eurosh. Mbështetja finlandeze do t'i shkojë Fondit të Koherencës, një grup financimesh, i pikësnyuar dhe shumë-vjeçar, që rrit efikasitetin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri duke lehtësuar, thjeshtuar dhe rritur harmonizimin dhe parashikueshmërinë e qarkullimit të burimeve. I udhëhequr nga Qeveria e Shqipërisë dhe i mbështetur në kontributin e 14 agjencive pjesëmarrëse, Programi Një OKB ndihmon në realizimin e prioriteteve kombëtare në pesë fusha kryesore: qeverisje më transparente dhe të përgjegjshme; pjesëmarrje më të madhe përfshirëse në politikat publike dhe vendim-marrje; qasje më të madhe dhe më të barabartë në shërbimet cilësore bazë; zhvillim rajonal për të ulur paparazitë; dhe zhvillim mjedisor të qëndrueshëm. Finlanda planifikon të investojë 38 milionë euro në zhvillimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në vitet 2009-2013.



Foto: Zyrtarë të rajoneve të Lezhës dhe Shkodrës, gjatë vizitës studimore në Slloveni për të mësuar për financimin dhe zbatimin e projekteve të BE-së për zhvillimin rajonal.

Qëllimi i bashkëpunimit finlandez për zhvillim është çrrënjësia e varfërisë dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe ekologjik, në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të OKB-së. Mbështetja për vendet e Ballkanit Perëndimor ndërtohet rreth temave të ndërlidhura të stabilitetit dhe sigurisë, ndihmës për tregtinë, mjedisit dhe qëndrueshmërisë sociale.

Ministria e Drejtësisë diskuton me donatorët strategjinë e Drejtësisë

“Strategjia për drejtësinë është një kontribut real për forcimin, funksionimin dhe zbatimin e regullave të shtetit ligjor si dhe respektimin e të drejtave të njeriut.” Me këto fjalë Ministri i Drejtësisë nisi procesin e konsultimit të draft strategjisë së Drejtësisë me donatorët që kontribuojnë në forcimin e institucioneve të drejtësisë në vend, që u mbajt më 24 janar 2011. “Në themel të kësaj strategjie do të jetë, zbatimi i shtetit ligjor si garancia e vetme e respektimit të të drejtave të njeriut si gur themellor i demokracisë në vend. Kjo strategji ndjek me vëmendje prioritetet që qeveria shqiptare ka në integrimin e saj në familjen evropiane”- theksoi ministri Nishani.

Ministri konsideroi si të rëndësishme objektivat që synon kjo strategji si krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, të një sistemi ky respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut, që rrezaton besueshmëri dhe transparencë, që ka si qëllim aksesin e qytetarëve dhe rritjen e besimit të tyre tek drejtësia. Më tej, ministri Nishani shprehu mirënjohjen për donatorët dhe assistencën e shteteve mike nëpërmjet misioneve të akredituara në vend, OSBE-së, Këshillit të Europës për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë ofruar Shqipërisë në konsolidimin e shtetit ligjor dhe forcimin e institucioneve të drejtësisë. Draftimi, konsultimi dhe marrja mendimeve nga të gjithë aktorët që veprojnë në fushën e drejtësisë synon finalizimin me një dokument të vetëm të projekt – politikave për zhvillimin në vazhdimësi të rolit dhe bashkërendimit të hallkave dhe aktorëve të sistemit gjyqësor. Ministria e Drejtësisë draftoi Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për gatë vitit të shkuar. Procesi ka vijuar me mbledhjen e informacionit, identifikimin e problematikave, vizionit, prioritetëve dhe objektivave strategjike për ta kthy-



Foto: Ministria e Drejtësisë diskuton me donatorët Strategjinë e Drejtësisë

er atë në një dokument të zbatueshëm gjithëpërfshirës. Rekomandimet e dhëna në këtë tryezë do të reflektohen në Planin e Veprimit.

PAMECA organizon kurse trainimi për çështjet detare



Foto: Kurs trainimi për përgatitjen e trajnerëve në zhvillimin e mëtejshëm të trajnimit për çështjet detare, organizuar nga PAMECA III

Një grup specialistësh, përfaqësuesish të agjencive – palë të interesit në lidhje me çështjet detare morën pjesë në kursin e trajnimit për përgatitjen e trajnerëve në zhvillimin e mëtejshëm të trajnimit për çështjet detare, për të gjithë punonjësit e agjencive detare përkatëse. Kursi i trajnimit u përqendrua në sigurimin e teknikave të trajnimit për trajnerët e ardhshëm detarë vendorë në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare Detare (OND) - standardet e OND-së dhe kërkesat e Konventës 95 të Standarteve të Çertifikimit, Trajnimit dhe Vëzhgimit. Pjesëmarrësit dhe përfaqësuesit nga Roja Bregdetare, Policia e Kufirit dhe Migracionit, Autoriteti Doganor Shqiptar, Administrata Detare dhe Inspektoriati i Peshkimit u prezantuan gjithashtu me strukturat dhe funksionimin e QND-së. Ky kurs trajnimi për trajnimin e instruktorëve u organizua nga Drejtoria e Policisë së Kufirit dhe Migracionit me asistencën dhe mbështetjen e Misionit PAMECA III. Kursi u zhvillua nga Eksperti afatshkurtër pranë Misionit PAMECA III Z. Rodrigo Garcia. Të pranishmit

në këtë kurs trajnimi u shprehën se kombinimi i teorisë dhe ushtrimeve me shpjegimin e çështjeve praktike, të cilat dalin gjatë aktivitetit të përditshëm të të gjithë grupeve të interesit detar, ishte një vlerë e shtuar e siguruar gjatë këtij kursi trajnimi.

BE financon modernizimin e shërbimeve kufitare drejt standardeve evropiane

Më 20 janar 2011, Policisë së Shtetit dhe Shërbimeve Doganore iu dorëzua Paketa Trajnuese e BE-së. Kjo paketë u përgatit në kuadër të projektit “PAMECA” të financuar nga BE dhe në mbështetje të Policisë së Shtetit, dhe u shpërnda nga projekti në të gjitha pikat e shërbimit kufitar nëpërmjet një programi “trajnimi të trajnuesve”, i cili është tashmë pjesë e kurrikulave të trajnimeve të shërbimeve kufitare.

Paketa përmirëson shërbimet e ofruara në kufi dhe mbështet luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe migrimit të jashtëligjshëm. Përforcimi i kontrollove kufitare është thelbësor në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe migrimit të jashtëligjshëm. Pas dy vitesh trajnimi për kontroll kufitar sipas standardeve të BE-së, projekti PAMECA dorëzon sot paketën përfundimtare të trajnimeve, e cila përfshin praktikën më të mira evropiane dhe shqiptare, module trajnimi për çështje të vjedhjeve të makinave, analizave të riskut, acquis së Shengenit, etj. Ky trajnim është kryer tashmë në të gjitha pikat e kalimit të kufirit dhe është pjesë e programit të përherëshëm të trajnimeve për shërbimet kufitare shqiptare. Projekti ka trajnuar trajnues të Policisë Kufitare dhe Migracionit, dhe të Administratës Doganore. Kurrikulat e hartuara dhe të ofruara nga projekti i shërbejnë zbatimit të acquis Shengen në këtë fushë, si dhe zbatimit të Strategjisë dhe Plan-Veprimit për Menaxhimin e In-

tegruar të Kufijve. Gjatë ceremonisë së dorëzimit, Sekretari i Parë i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Aneil Singh, theksoi se “lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe menaxhimi i mirë i kufijve mbeten çështje kyçe për agjendën e zgjerimit të BE-së, dhe për ngritjen e një zone drejtësie dhe lirie. Menaxhimi i mirë i kufijve do të përmirësojë edhe mbrojtjen e lirive themeltare”. Kostoja totale e projektit PAMECA është mbi 6 milionë euro. Zbatimi i tij filloi në mes të vitit 2008. Një komponent i rëndësishëm i këtij projekti është asistenca e dhënë në fushën e menaxhimit të kufijve. Projekti zbatohet nga Mbretëria e Bashkuar në partneritet me Austrinë.

Kurs trajnimi mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi shëndetin



Foto: Mchal Krzyszanowski duke drejtuar kursin e trainimit mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi shëndetin

Ne kuadrin e projektit “Mbrojtja e shëndetit nga ndryshimet klimatike në Shqipëri” në zbatim nga Ministria e Shëndetësisë me mbështetjen e OBSH nëpërmjet një fondi të Ministrisë Gjermane të Mjedisit, u mbajt një kurs trajnimi mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi shëndetin. Trainimi u krye në ambientet e Institutit të Shëndetit Publik nga dt 26 Janar-4 Shkurt 2011 dhe u mbështet nga ekspertiza e ofruar nga OBSH dhe Ministria e Shëndetësisë. Pjesëmarrësit përfaqësonin punonjës të shëndetit publik të cilët u njohën me konceptet e ndryshimit klimatik, ndikimet në shëndetin e njerëzve, indikatorët për matjen e një ndryshimi të tillë, masat parandaluese dhe përshtatëse dhe strategjitë e komunikimit me publikun. Objektivi kryesor i këtij kursi ishte ngritja e kapaciteteve për hartimin e strategjisë kombëtare mbi ndryshimet klimatike dhe impaktin në shëndet si edhe fuqizimi i punonjësve të shëndetit publik në promovimin e sjelljeve të shëndetshme në raport me ndryshimet klimatike.

Misionet në vend

Në datat 6 deri më 11 janar 2011, zhvilloi vizitë Misioni i Bankës Botërore për Vlerësimin Programatik të Varfërisë në Vendet e Ballkanit Perëndimor.

Qëllimet e Misioni ishin: (i) të diskutonte për fushat e bashkëpunimit me INSTAT-in në të ardhmen, përfshirë përfundimin e veprimtarive për ndërtimin e kapaciteteve, të lidhura me përpunimin e të dhënave për të ardhurat në fshat; (ii) të diskutonte me donatorë të tjerë për bashkëpunimin e ardhshëm në veprimtarinë e re të monitorimit gjinor, që do të zhvillohet rregullisht nga Banka Botërore; dhe (iii) të informohej për ecurinë e Projektit të Qeverisjes Ekonomike në sektorin e Ujit dhe të Energjetikës, të zhvilluar së bashku me PNUD-in.

Në datat 19 deri më 21 janar 2011, në Tiranë u zhvillua një seminar i Bankës Botërore për Menaxhimin Financiar dhe Disbursimin.

Në seminar ishin ftuar të merrnin pjesë të gjithë ekspertët e financave, të cilët zbatojnë projekte të financuara nga Banka Botërore në Shqipëri dhe Kosovë. Specialistja e Lartë e Menaxhimit Financiar, Ida Njeri Muhoho, realizoi mbikëqyrjen e menaxhimit financiar të Projektit Zbutja dhe Përshtatja ndaj Rrezikut të Fatkeqë-

sive, Projektit Sistemi Shëndetësor dhe Modernizimi i Tij, dhe Projektit Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës në Shqipëri, për të vlerësuar efektivitetin e vazhdueshëm të mekanizmeve të menaxhimit financiar, të ngritur për zbatimin e këtyre projekteve.

Në datat 24 deri më 28 janar zhvilloi vizitë Misioni i Bankës Botërore për Portofolin e Sektorit të Energjetikës në Shqipëri.

Gjatë këtyre ditëve, Misioni mbikëqyri Projektet e Sektorit të Energjetikës në Shqipëri (Projektin TPP në Vlorë - PSGRP, Projektin e Transmisionit - ECSSE APL2, Projektin e për Sigurinë e Digave - EC-SEE APL5 dhe Projektin për Garancinë e Rrezikut të Pjesëshëm – Privatizimi në Shpërndarje). Qëllimet kryesore të Misionit ishin (i) të vlerësonte përparimin e bërë në zbatimin e portofolit të lart-përmendur në sektorin e energjetikës; (ii) të diskutonte për hapat dhe mekanizmat e mëtejshëm për Financimin Shtesë të kërkuar nga Ministri i Financave më 12 janar 2011; dhe (iii) të merrte pjesë në Takimin e Donatorëve / Huadhënësve të Sektorit, të zhvilluar në datat 26-27 janar 2011. Çështje të tjera gjatë Misionit përfshinë: i) finalizimin nga Qeveria të procesit të risstrukturimit, përfshirë kundër-firmosjen e amendamenteve ligjore për Projektin EC-SEE-APL2, ii) vlerësimin e mekanizmeve të financimit të përgjithshëm për projektin EC-SEE-APL5, dhe iii) pjesëmarrjen në seminarin me donatorët e projektit, të organizuar nga KESH në datat 24-25 janar 2011.

dialoguqeveridonatorë

Nga data 15 dhjetor 2010 Banka Botërore mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë më se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.como@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (arselma.kabashi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t'ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

Për t'u regjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.como@aidharmonisation.org.al)

Buletini “Dialogu Qeveri-Donatorë” mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

osce

